



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“MEKATRONIKË NË MJETET E RËNDA TË TRANSPORTIT”

Niveli V në KSHK¹, referuar nivelit V të KEK²

M3-V-25

(Përgatitur me mbështetjen e ERI SEE)

Tiranë, 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi	4
Kohëzgjatja	4
Niveli	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesit	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME (qëndrimet)	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
NjN-12-V-0345-25 Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve të punës dhe parapërgatitjes për punë	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-12-V-0346-25 Pranimi, inspektimi dhe diagnostikimi i defekteve në kamionë dhe mjete të rënda	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-12-V-0347-25 Shërbime në sistemet hidraulike dhe pneumatike të kamionëve dhe mjeteve të rënda	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
NjN-12-V-0348-25 Shërbime në motor dhe në sistemin e transmetimit të fuqisë në kamionë dhe mjete të rënda	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-12-V-0349-25 Shërbime në sistemet elektrike/elektronike të kamionëve dhe mjeteve të rënda	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13
NjN-12-V-0350-25 Shërbime në sisteme të komfortit, të sigurisë aktive dhe pasive, të sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kriteret e vlerësimit	15

NjN-12-V-0351-25 Garantimi i cilësisë së shërbimeve në mjetet e rënda të transportit	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	16
NjN-23-V-0111-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	17
Kriteret e vlerësimit	17
NjN-22-V-0130-24 Komunikimi dhe etika profesionale	17
Rezultatet e të nxënit në njohuri	17
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	17
Kriteret e vlerësimit	18
NjN-12-V-0352-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në mekatronikën e mjeteve të rënda të transportit	18
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	19
Kriteret e vlerësimit	19
Njësitë e të nxënit dhe peshat përkatëse	19
Modalitetet e vlerësimit	20
Informacion shtesë	20
SHËNIM	21

Emërtimi i kualifikimit	“Mekatronikë në mjetet e rënda të transportit”			Kodi
Kohëzgjatja	1500 orë nocionale	Niveli	Niveli V në KSHK, referuar nivelit V në KEK	M3-V-25
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Mekatronikë në mjetet e rënda të transportit” niveli V-të në KSHK, referuar nivelit V të KEK, është të përgatisë teknikë të lartë për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve elektrike, elektronike dhe mekatronike të mjeteve të transportit, si dhe të zhvillojë personalitetin e tyre për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “Mekatronikë në mjetet e rënda të transportit”, niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kanë mbaruar arsimin e mesëm, niveli IV në KSHK, në “Shërbime mjetesh transporti”. - Kanë mbaruar arsimin e mesëm, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK dhe kanë një përvojë pune të vërtetuar në fushën përkatëse prej një vit; - Kanë njohuri të mira në gjuhë të huaja (anglisht); - Kanë njohuri të mira kompjuterike dhe informatike; - Të jenë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; - Pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional në “Mekatronikë në mjetet e rënda të transportit”, niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës, në këtë fushë profesionale, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t`i drejtohet tregut të punës për punësim në pika servisi të mjeteve të rënda transporti, veprimtaritë e tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve të transportit, si dhe në veprimtari të tjera që ushtrohen në këtë drejtim. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e mirëmbajtjes dhe riparimit të shërbime mekatronike të mjeteve të rënda të transportit apo mjete të lehta të transportit.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesional “Mekatronikë në mjetet e rënda të transportit”, niveli V-të në KSHK, referuar nivelit V të KEK, individi mund të vazhdojnë studimet universitare.</p>			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	<i>Qershor 2025</i>			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme				

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Mekatronikë në mjetet e rënda të transportit” niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME (QËNDRIMET)

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tij, si dhe për të argumentuar opinione për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore, profesionale dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-12-V-0345-25 Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve të punës dhe parapërgatitjes për punë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë legjislacionin bazë për shërbimet në mjetet e transportit;

2. Të përshkruajë legjislacionin përkatës për kushtet e punës dhe vendit të punës;
3. Të shpjegojë llojet e strukturave organizative të autoserviseve;
4. Të shpjegojë llojet e shërbimeve në një autoservis;
5. Të klasifikojë instrumentet, pajisjet dhe mjetet të punës, sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
6. Të interpretojë të dhënat teknike të mjetit bazuar në dokumentacionin përkatës;
7. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të manualeve teknike;
8. Të interpretojë skema dhe bllok-skema të ndryshme;
9. Të listojë llojet e programeve për diagnozën dhe për pjesët e këmbimit dhe përdorimi i tyre;
10. Të klasifikojë materialet, sipas llojit dhe përdorimit të tyre;
11. Të tregojë mënyrat e kontrollit të funksionalitetit dhe sigurisë në përputhje me standardet;
12. Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të punës sipas proceseve;
13. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të burimeve njerëzore;
14. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të burimeve materiale etj.;
15. Të theksojë rëndësinë e koordinimit të punës për sigurimin e burimeve;
16. Të përshkruajë mënyrën e hartimit të grafikut të punimeve sipas proceseve të punës;
17. Të tregojë mënyrën e ndarjes së detyrave sipas agjendës ditore, javore dhe kualifikimeve përkatëse;
18. Të shpjegojë mënyrat e mbledhjes së informacioneve për mbarëvajtjen e punëve;
19. Të tregojë rëndësinë dhe format e bashkëpunimit me palë të treta dhe specialistë të tjerë;
20. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së organizimit ergonomik të vendit të punës;
21. Të shpjegojë format e raportimit;
22. Të përshkruajë procedurat e monitorimit për zbatimin e rregullave për mirëmbajtjen dhe higjienën personale, të mjeteve, pajisjeve dhe të vendit të punës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të hartojë grafikun e kontrollit të funksionalitetit të mjeteve, pajisjeve dhe instrumenteve të punës, sigurinë në përputhje me standardet;
2. Të planifikojë punën, burimet njerëzore dhe materialet e punës sipas proceseve;
3. Të hartojë të grafikut të punimeve sipas proceseve të punës;
4. Të ndajë detyrat sipas agjendës ditore, javore dhe kualifikimeve përkatëse;
5. Të bashkëpunojë me palë të treta dhe specialistë të tjerë;
6. Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
7. Të raportojë tek eprori për ecurinë e punës (sipas rregullave të brendshme);
8. Të mbikëqyrë procedurat e monitorimit për zbatimin e rregullave për mirëmbajtjen dhe higjienën personale të mjeteve, pajisjeve dhe të vendit të punës.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr zbatimin e grafikun e kontrollit të funksionalitetit të mjeteve, pajisjeve dhe instrumenteve të punës, sigurinë në përputhje me standardet;
- Planifikon materialet dhe pjesët e këmbimit sipas kërkesës;
- Planifikon burimet njerëzore sipas proceseve të punës dhe kërkesës;
- Planifikon kohën e shërbimeve të mjetit sipas llojit të defektit;

- Planifikon mjetet, pajisjet dhe instrumentet e punës sipas kërkesës;
- Përcakton proceset e punës sipas llojit të defektit në sisteme;
- Përcakton radhën e punës sipas proceseve të punimeve;
- Përgatit/zbaton urdhrin e punës sipas llojit të punimit;
- Mbikëqyr përgatitjen e vendit të punës sipas rregulloreve përkatëse;
- Përzgjedh mjetet, materialet dhe pajisjet e punës sipas planifikimit të kryer, proceseve të punës dhe llojeve të shërbimit;
- Ndan detyrat sipas agjendës ditore, javore dhe kualifikimeve përkatëse;
- Zbaton radhën e punës sipas procesit të shërbimit;
- Organizon vendin e punës në mënyrë ergonomike sipas standardeve përkatëse;
- Raporton tek eprori për ecurinë e punës sipas rregullores së brendshme;
- Mbikëqyr mirëmbajtjen, pastrimin dhe sistemimin e veglave dhe vendit të punës (para, gjatë dhe pas punës) sipas manualeve përkatës, rregullores së brendshme dhe procedurave përkatëse;
- Dokumenton punën e kryer sipas procesit të punës.

NjN-12-V-0346-25 Pranimi, inspektimi dhe diagnostikimi i defekteve në kamionë dhe mjete të rënda

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e konsultimit me librin e shërbimeve, historikun e shërbimeve të automjetit dhe marrjes së informacionit të saktë nga përdoruesi i mjetit;
2. Të përshkruajë procedurat dhe formatet e pranimit të mjetit;
3. Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të gjendjes fillestare dhe historikut të diagnozës së mjeteve të rënda;
4. Të përshkruajë formatin dhe elementët e një urdhri pune;
5. Të klasifikojë llojet e mjeteve të rënda, specifikimet dhe karakteristikat e tyre;
6. Të përshkruajë procedurat e inspektimit fizik të mjetin gjatë pranimit;
7. Të shpjegojë llojet e pajisjeve testuese dhe përdorimi i tyre;
8. Të shpjegojë llojet e pajisjeve dhe programeve diagnostikuese, si dhe përdorimi i tyre;
9. Të shpjegojë llojet e matjeve, instrumenteve matëse dhe përdorimet e tyre;
10. Të përshkruajë llojet e sistemeve (elektrike, elektronike, mekanike ...) të mjeteve të rënda dhe funksioni i tyre;
11. Të shpjegojë procedurat e diagnostikimit të sistemeve;
12. Të analizojë kodet e gabimeve duke i interpretuar ato;
13. Të shpjegojë procedurat e testimit të motorit;
14. Të shpjegojë procedurat e testimit të sistemit të transmetimit të fuqisë;
15. Të shpjegojë procedurat e testimit të sistemit elektrik/elektronik;
16. Të shpjegojë procedurat e testimit të sistemit të drejtimit dhe frenimit;
17. Të shpjegojë procedurat e testimit të sistemeve ndihmëse dhe të komfortit;
18. Të shpjegojë procedurat e testimit të sistemit të ushqimit dhe shkarkimit të gazeve;
19. Të klasifikojë llojet e defekteve kryesore sipas sistemeve;
20. Të shpjegojë rëndësinë e përditësimeve të softuerit të paketave elektronike (ECU) sipas

sistemeve;

21. Të shpjegojë procedurat e analizës së rezultateve të diagnostikimit përmes softuerëve përkatës;
22. Të argumentojë mënyrat e mundshme të riparimit të elementeve me defekt;
23. Të argumentojë rëndësinë e informimit të klientit dhe eprorit sipas rregullores së brendshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të marrë informacionin e duhur nga libri, historiku i shërbimeve të automjetit dhe nga përdoruesi i mjetit;
2. Të plotësojë formatet e pranimit të mjetit dhe urdhrin e pune;
3. Të zbatojë procedurat e inspektimit fizik dhe kontrollit paraprakë të mjetin gjatë pranimit;
4. Të zbatojë procedurat e diagnostikimit të sistemit elektrike, elektronike duke përdorur pajisje dhe programe diagnostikuese të ndryshme ;
5. Të konstatojë dhe analizojë kodet e gabimeve për lokalizimin e defekteve në sisteme;
6. Të kontrollojë sistemet mekanike të mjeteve të renda për parregullsi të mundshme;
7. Të zbatojë procedurat e kontrollit të motorit të mjeteve të renda për parregullsi të mundshme;
8. Të zbatojë procedurat kontrollit të sistemit të transmetimit të fuqisë të mjeteve të renda për parregullsi të mundshme;
9. Të zbatojë procedurat kontrollit të sistemit të komandimit (drejtimit dhe frenimit) të mjeteve të renda për parregullsi të mundshme;
10. Të zbatojë procedurat kontrollit të sistemeve ndihmëse dhe të komfortit të mjeteve të renda për parregullsi të mundshme;
11. Të zbatojë procedurat kontrollit të sistemit varjes dhe ecjes së mjeteve të renda për parregullsi të mundshme;
12. Të konstatojë defektet, sipas sistemeve;
13. Të interpretojë kodet e gabimeve dhe të dhënat nga kontrollet e kryera sipas udhëzimeve të prodhuesit;
14. Të krahasojë parametrat aktual me ato të dhëna nga prodhuesit;
15. Të gjykojë opsionet e mundshme të riparimit dhe zëvendësimit të elementeve me defekt;
16. Të informojë klientin dhe eprorin për parregullsitë e mundshme pas procesit të diagnostikimit dhe kontroleve;
17. Të përditësojë të dhënat e paketave elektronike (ECU) sipas sistemeve.

Kriteret e vlerësimit

- Marr informacionin e duhur nga libri dhe historiku i shërbimeve të automjetit sipas procedurave të paracaktuara;
- Marr informacioni të saktë dhe në kohë nga përdoruesi i mjetit;
- Hedh të dhënat e mjetin në formatin përkatës sipas rregullores së brendshme;
- Zbaton procedurat për inspektimin fizik sipas rregullores së brendshme;
- Zbaton procedurat për kontrollin vizual sipas udhëzimeve përkatëse;
- Zbaton procedurat për kontrollin akustik (dëgjimor) sipas udhëzimeve përkatëse;
- Lidh mjetin me pajisjen diagnosikuese të sistemit elektrike, elektronike sipas udhëzimeve të prodhuesit;

- Lexon diagnozën në sistemet elektrike, elektronike sipas kodeve të parregullsisë;
- Identifikon parregullsitë në sisteme sipas informacionit të marrë nga diagnoza;
- Lokalizon parregullsitë në sistemet përkatëse sipas informacionit të marrë nga diagnoza;
- Kryen kontrolle të parametrave në sistemet mekanike të mjetit sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave për testimin e motorit sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave për testimin e sistemit të transmetimit të fuqisë sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave për kontrollin e sistemit të drejtimit sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave për kontrollin e sistemit të frenimit sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave për kontrollin e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimit sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave për kontrollin e sistemit të varjes sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave për kontrollin e sistemit të ecjes sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Kontrollon zbatimin e procedurave për kontrollin e parregullsive në sistemet ndihmëse dhe të komfortit sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Konstaton defektet, sipas sistemeve;
- Interpretin kodet e gabimeve dhe të dhënat nga kontrollet e kryera sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Krahason parametrat aktual me ato të dhëna nga prodhuesit;
- Përditëson të dhënat e paketave elektronike (ECU) sipas sistemeve;
- Përcakton opsionet e mundshme të riparimit dhe zëvendësimit të elementeve me defekt sipas llojit të defektit;
- Informon eprorin për parregullsitë e mundshme pas procesit të diagnostikimit dhe kontrolleve sipas rregullores së brendshme;
- Informon klientin për parregullsitë e mundshme pas procesit të diagnostikimit dhe kontrolleve sipas rregullores së brendshme;
- Plotëson urdhrin e punës pas diagnostikimit të kryer sipas rregullores së brendshme.

NjN-12-V-0347-25 Shërbime në sistemet hidraulike dhe pneumatike të kamionëve dhe mjeteve të rënda

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë parimet dhe ligjet bazë të hidraulikës dhe pneumatikës;
2. Të përshkruajë parimin e funksionimit të sistemit me ajër të kompresuar;
3. Të përshkruajë dallimet ndërmjet sistemeve të mbyllura (hidraulike) dhe të hapura (pneumatike);
4. Të përshkruajë komponentët e sistemeve pneumatike dhe hidraulike, si dhe funksionin e tyre;
5. Të interpretojë skemat teknike (hidraulike/pneumatike/elektrike);

6. Të shpjegojë defektet përmes simptomave dhe procedurat e riparimit të tyre;
7. Të shpjegojë përdorimin e pajisjeve matëse dhe testuese (testues presioni, matës rrjedhjeje, manometër);
8. Të klasifikojë vajrat sipas specifikimeve (lloji, viskoziteti, temperatura operative) dhe rëndësia e tyre në sistemet hidraulike;
9. Të shpjegojë elementët e sistemit hidraulik (pompat, pistonat, shpërndarësit, filtrat, rezervuarët, radiator/ftohës vaji hidraulik) dhe procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të tyre;
10. Të shpjegojë elementët e sistemit pneumatik (kompresorët, rezervuar dhe filtra, valvula dhe shpërndarës, pistonat pneumatikë) dhe procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të tyre;
11. Të shpjegojë lidhjet e linjave hidraulike dhe pneumatike;
12. Të shpjegojë mënyrën e kontrollit të pajisjeve komanduese përmes levave, pulteve elektronike etj.;
13. Të përshkruajë llojet e mirëmbajtjeve periodike të sistemit hidraulik dhe pneumatik sipas procedurave përkatëse.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave të riparimit në sistemet hidraulike dhe pneumatike sipas proceseve dhe skemave teknike;
2. Të kryejë matje dhe testime të ndryshme në sistemin hidraulik dhe pneumatik me mjetet dhe pajisjet përkatëse (testues presioni, matës rrjedhjeje, manometër);
3. Të interpretojë specifikimet e vajrave (lloji, viskoziteti, temperatura operative) në sistemet hidraulike;
4. Të mbikëqyrë procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të elementëve të sistemit hidraulik (pompat, pistonat, shpërndarësit, filtrat, rezervuarët, radiator/ftohës vaji hidraulik);
5. Të mbikëqyrë procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të elementëve të sistemit pneumatik (kompresorët, rezervuar dhe filtra, valvula dhe shpërndarës, pistonat pneumatikë) dhe procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të tyre;
6. Të kontrollojë lidhjet e linjave hidraulike dhe pneumatike;
7. Të kontrollojë pajisjet komanduese në sistemet hidraulike dhe pneumatike;
8. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave për mirëmbajtjet periodike të sistemit hidraulik dhe pneumatik.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh materialet për mirëmbajtje periodike sipas specifikimeve përkatëse dhe llojit të mjetit
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave për mirëmbajtjet periodike të sistemit hidraulik dhe pneumatik;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të kontrollit të nivelit të vajit sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Kontrollon zbatimin e procedurave të ndërrimit të vajrave hidraulike sipas udhëzimeve përkatëse;
- Kontrollon zbatimin e procedurave të ndërrimit të filtrave sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të zëvendësimit dhe riparimit të pompave sipas udhëzimeve të prodhuesit;

- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të zëvendësimit dhe riparimit të shpërndarësve sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të zëvendësimit dhe riparimit të kompresorëve sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të zëvendësimit dhe riparimit të valvulave sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të zëvendësimit dhe riparimit të pistonave sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të zëvendësimit dhe riparimit të elementëve të sistemit hidraulik dhe pneumatik, sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Kontrollon parametrat e sistemeve hidraulike dhe pneumatike, duke përdorur pajisjet dhe instrumentet përkatëse, sipas udhëzimeve të prodhuesit;

NjN-12-V-0348-25 Shërbime në motor dhe në sistemin e transmetimit të fuqisë në kamionë dhe mjete të rënda

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të klasifikojë tipet e motorëve, parimin e punës dhe funksionin e tyre;
2. Të përshkruajë motorët me djegie të brendshme (MDB), ndërtimin dhe funksionimin e tyre;
3. Të përshkruajë dallimet dhe karakteristikat e punës së motorit nëpërmjet kontrollit vizual dhe akustik (dëgjimor);
4. Të listojë llojet e shërbimeve periodike në motor dhe sistemet e tij, si dhe mënyrën e kryerjes së tyre;
5. Të listojë llojet e shërbimeve periodike në agregatet e sistemit të transmetimit të fuqisë, si dhe mënyrën e kryerjes së tyre;
6. Të përshkruajë defektet kryesore në motor, si dhe procedurat e riparimit të tyre;
7. Të përshkruajë sistemin e ushqimit, funksionin, ndërtimin, parregullsitë dhe metodat e riparimit të elementëve të dëmtuara;
8. Të përshkruajë sistemin e transmetimit të fuqisë dhe mënyrat e komandimit, ndërtimin dhe pjesët përbërëse;
9. Të përshkruajë mënyrën e riparimit dhe zëvendësimit të mekanizmave, elementëve të motorit dhe sistemeve ndihmëse të tij;
10. Të përshkruajë mënyrën e riparimit dhe zëvendësimit të aggregateve në sistemin e transmetimit të fuqisë;
11. Të përshkruajë mënyrën e riparimit dhe zëvendësimit të elementeve të komandimit të sistemit të transmetimit të fuqisë;
12. Të listojë parametrat teknik të transmetimit të fuqisë;
13. Të përshkruajë procedurat e testimit të performancës së motorit, si dhe funksionimin e mekanizmave dhe sistemeve ndihmëse pas riparimit;
14. Të përshkruajë procedurat e testimit dhe funksionit të sistemit të transmetimit të fuqisë pas riparimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave të mirëmbajtjeve periodike të motorit;
2. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave të mirëmbajtjeve periodike të agregateve të sistemit të transmetimit të fuqisë;
3. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave të riparimit dhe zëvendësimit të mekanizmave, elementëve të motorit dhe sistemeve ndihmëse të tij;
4. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave të riparimit dhe zëvendësimit të agregateve në sistemin e transmetimit të fuqisë;
5. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave të riparimit dhe zëvendësimit të elementeve të komandimit të sistemit të transmetimit të fuqisë;
6. Të kryejë testimin dhe kontrollin përfundimtar të performancës së motorit pas riparimit duke përdorur mjete dhe pajisje të përshtatshme, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit;
7. Të kryejë testimin dhe kontrollin përfundimtar të agregatëve të sistemit të transmetimit të fuqisë pas riparimit, duke përdorur mjete dhe pajisje të përshtatshme, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh pjesët dhe materialet e nevojshme për mirëmbajtje periodike sipas katalogëve përkatës;
- Mbikëqyr procedurat të mirëmbajtjeve periodike të motorit sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr procedurat të mirëmbajtjeve periodike të agregatëve të sistemit të transmetimit të fuqisë, sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Përzgjedh pjesët e nevojshme për riparime apo zëvendësime sipas katalogëve të mjetit përkatës;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të riparimit dhe zëvendësimit të mekanizmave apo elementëve të motorit sipas procedurave përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të riparimit dhe zëvendësimit të mekanizmave apo elementëve sistemit të ushqimit sipas procedurave përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të riparimit dhe zëvendësimit të mekanizmave, elementëve të sistemeve ndihmëse të tij sipas procedurave përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të riparimit dhe zëvendësimit të elementëve në agregatët e sistemit të transmetimit të fuqisë, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit;
- Kryen kontrolle të agregatëve dhe parametrave pas riparimit në përputhje me udhëzimet e prodhuesit
- Kryen kontrollin përfundimtar në ngarkesë të mjetit sipas procedurave të prodhuesit.

NjN-12-V-0349-25 Shërbime në sistemet elektrike/elektronike të kamionëve dhe mjeteve të rënda

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë sistemet elektrike dhe elektronike dhe përbërësit e tyre;
2. Të përshkruajë llojet e defekteve elektrike në sistemet e mjetit;
3. Të shpjegojë pajisjet matëse të sistemit elektrik (indikator, multimeter, avometer, klapmeter etj.) funksionin dhe përdorimin e tyre;

4. Të përshkruajë skemën e sistemit të lëshimit dhe karikimit;
5. Të shpjegojë procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të elementëve të sistemit të lëshimit dhe karikimit;
6. Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të elementëve të sistemit ndriçues dhe sinjalizues;
7. Të përshkruajë llojet e komandimit elektronik të sistemit të ushqimit, si dhe procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të tyre;
8. Të përshkruajë llojet e sensorëve aktiv dhe pasiv, aktuatorët, veçoritë e tyre sipas funksionit dhe procedurat e zëvendësimit të tyre;
9. Të përshkruajë motorët elektrik HV, ndërtimin dhe funksionimin e tyre;
10. Të listojë parametrat teknik dhe konstruktiv të motorëve elektrikë HV;
11. Të përshkruajë llojet e baterive HV, lidhjet, kontrollin dhe procedurat e zëvendësimit të tyre;
12. Të përshkruajë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes së sistemit HV;
13. Të përshkruajë procedurat e testimit dhe funksionit të sistemeve elektrike të riparuar.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë matjen e parametrave elektrikë dhe i krahason me standardet dhe normat e përcaktuara në manualet përkatëse sipas procedurave të paracaktuara;
2. Të lokalizojë defektin në sistemet elektrike, paketat elektronike dhe komponentët kompjuterikë, duke përdorur pajisjeve diagnostikuese dhe testuese;
3. Të kontrollojë përputhshmërinë e pjesëve/elementeve për zëvendësim me specifikimet e tyre sipas kodeve dhe tipit të automjetit, sipas katalogëve të prodhuesit;
4. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave për punime elektrike (çmontim/montim, riparim, zëvendësim, rregullim parametrash – kalibrim...) në sistemin e furnizimit me energji elektrike, sistemin e ndezjes së motorit, sistemin e ndriçimit, sinjalizimit dhe në funksione ndihmese të automjetit, sipas manualeve të prodhuesit dhe programeve kompjuterike;
5. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave për punime elektrike në sistemin e injektimit të karburantit sipas manualeve përkatëse;
6. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave të zëvendësimit të sensorëve dhe aktuatorëve në sistemet elektronike sipas manualeve përkatëse;
7. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave për aktivizim/çaktivizim të baterisë HV në mjetet elektrike dhe hibride sipas udhëzimeve të prodhuesit;
8. Të kryejë testimin e funksionalitetit të pjesëve të riparuar ose të zëvendësuar sipas procedurave të dhëna nga prodhuesi;

Kriteret e vlerësimit

- Mat parametrave elektrikë/elektronike dhe i krahason me standardet dhe normat e përcaktuara në manualet përkatëse sipas procedurave të paracaktuara;
- Demonstron përdorimin e pajisjeve matëse të sistemit elektrik, sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Analizon të dhënat të diagnostikimit për lokalizimin e defektit në sistemet elektrike, paketat elektronike dhe komponentët kompjuterikë, sipas procedurave përkatëse;

- Kontrollon përputhshmërinë e pjesëve/elementeve për zëvendësim me specifikimet e tyre sipas kodeve, tipit të automjetit dhe katalogëve të prodhuesit;
- Mbikëqyr punimet elektrike (çmontim/montim, riparim, zëvendësim etj.) në sistemet e furnizimit me energji elektrike dhe lëshimit të motorit sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr punimet elektrike (çmontim/montim, riparim, zëvendësim, rregullim parametrash–kalibrim...) të sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimit sipas manualeve të prodhuesit dhe programeve;
- Zëvendëson sensorët dhe aktuatorët në sistemet elektronike, sipas manualeve të prodhuesit dhe programeve kompjuterike;
- Kryen çaktivizim/aktivizim, zëvendësim të baterisë në automjetet elektrike dhe hibride HV me (tension të lartë), konvertuesit HV), sipas procedurave të prodhuesit;
- Teston funksionalitetin e pjesëve të riparuar ose të zëvendësuara sipas procedurave të dhëna nga prodhuesi;

NjN-12-V-0350-25 Shërbime në sisteme të komfortit, të sigurisë aktive dhe pasive, të sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë llojet e riparime në sistemet e komfortit, të sigurisë aktive dhe pasive, të sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit;
2. Të shpjegojë llojet e materialeve për riparimet në sistemet e komfortit, të sigurisë aktive dhe pasive, të sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit;
3. Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së materialeve sipas udhëzimeve të prodhuesit;
4. Të shpjegojë procedurat e kontrollit të gjendjes fizike të sistemeve të komfortit, të sigurisë aktive dhe pasive, sistemeve sinjalizuese;
5. Të shpjegojë procedurat e kontrollit, riparimit dhe zëvendësimit të elementeve të sistemit të ngrohjes dhe ftohjes;
6. Të shpjegojë pajisjet testuese e cikluese të sistemit ftohës dhe përdorimet e tyre;
7. Të shpjegojë procedurat e kontrollit, riparimit dhe zëvendësimit të sistemeve të ngritësit elektrikë të xhamave, mbylljes qendrore, rregullimit të sediljeve, sistemin multimedial dhe njësitë e kontrollit, ndriçimin dhe komfortin e kabinës...);
8. Të shpjegojë procedurat e kontrollit, riparimit dhe zëvendësimit të elementeve: ABS kundër bllokimit të frenave, ESP – kontrolli elektronik i stabilitetit, sistemin e ndihmës së frenimit (BA, EBA, BAS), sistemet e ndihmës në drejtim (ADAS), sistemin e kontrollit të parandalimit të rrëshqitjes (ASR, TCS), kamerat, sensorët e distancës, kufizues shpejtësie, ndihmën kompjuterike për mbajtjen e korsisë, tahografi...);
9. Të shpjegojë procedurat e kontrollit, riparimit dhe zëvendësimit të sistemit të sigurisë pasive, AIRBAG, rripat e sigurisë;
10. Të shpjegojë procedurat e testimit dhe funksionalitetit të sistemeve me pajisjet testuese.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë materialet për riparimet në sistemet e komfortit, të sigurisë aktive dhe pasive, të

- sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit sipas udhëzimeve të prodhuesit;
2. Të mbikëqyrë procedurat e riparimit dhe zëvendësimit të elementeve të sistemit të ngrohjes dhe ftohjes duke përdorur pajisjet testuese dhe cikluese;
 3. Të mbikëqyrë procedurat e riparimit dhe zëvendësimit të sistemeve, ngritësit elektrikë të xhamave, mbylljen qendrore, rregullimin e sediljeve, sistemin multimedial dhe njësitë e kontrollit, ndriçimin e kabinës);
 4. Të mbikëqyrë procedurat e riparimit dhe zëvendësimit të elementeve: ABS kundër bllokimit të frenave, ESP – kontrolli elektronik i stabilitetit, sistemin e ndihmës së frenimit (BA, EBA, BAS), sistemet e ndihmës në drejtim (ADAS), sistemin e kontrollit të parandalimit të rrëshqitjes (ASR, TCS), kamerat, sensorët e distancës, kufizues shpejtësie, ndihmën kompjuterike për mbajtjen e korsisë, tahografi...);
 5. Të mbikëqyrë procedurat e riparimit dhe zëvendësimit të sistemit të sigurisë pasive AIRBAG, rripat e sigurisë.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh materialet për riparimet në sistemet e komfortit, të sigurisë aktive dhe pasive, të sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr procedurat e riparimit dhe zëvendësimit të elementeve të sistemit të ngrohjes dhe ftohjes duke përdorur pajisjet testuese dhe cikluese sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr procedurat e riparimit dhe zëvendësimit të elementeve në sistemet moderne të sigurisë (ABS) (BA, EBA, BAS, ESP etj., sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr procedurat e riparimit dhe zëvendësimit të elementeve në sistemet pasive, AIRBAG, rripat e sigurisë sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Mbikëqyr procedurat e riparimit dhe zëvendësimit të elementeve të sistemeve, ngritësit elektrikë të xhamave, mbylljen qendrore, rregullimin e sediljeve, sistemin multimedial dhe njësitë e kontrollit, ndriçimin e kabinës) sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Realizon kontrollin përfundimtar të riparimeve të kryera sipas udhëzimeve të prodhuesit.

NjN-12-V-0351-25 Garantimi i cilësisë së shërbimeve në mjetet e rënda të transportit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë parimet bazë të Standardeve të Cilësisë Kombëtare dhe Ndërkombëtare;
2. Të shpjegojë parimet e menaxhimit të cilësisë;
3. Të listojë proceset dhe instrumentet e kontrollit të cilësisë në mjetet të rënda;
4. Të shpjegojë metodologjitë e menaxhimit të riskut dhe të përmirësimit të vazhdueshëm në sistemet e transportit të rëndë;
5. Të shpjegojë rëndësinë e dokumentacionit teknik, historikut të shërbimeve të kryera dhe dokumentacioneve të tjera;
6. Të argumentojë rëndësinë e përzgjedhjes së pjesëve të zëvendësimit sipas specifikimeve të prodhuesit dhe rolin e tyre në sigurimin e cilësisë së shërbimeve;
7. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të burimeve të sigurta për sigurimin e pjesëve të zëvendësimit;

8. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të procedurave dhe udhëzimeve të prodhuesit gjatë riparimeve në mjetet e rënda;
9. Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit të informacioni dhe trajnimeve lidhur me teknologjitë e reja të diagnostikimit në mjetet e rënda të transportit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë pjesët e këmbimit sipas specifikimeve të prodhuesit për të siguruar cilësinë e shërbimeve;
2. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave standarde të mirëmbajtjes dhe riparimit në mjetet e rënda të transportit;
3. Të përdorë pajisjet dhe instrumentet e diagnostikimit teknik sipas manualeve përkatëse dhe udhëzimeve të prodhuesit;
4. Të zbatojë procedurat përkatëse për kontrollin e cilësisë dhe verifikimin teknike gjatë dhe pas përfundimit të shërbimeve;
5. Të dokumentojë dhe ruajë informacionin përkatës për shërbimet e kryera;
6. Të përdorë praktika të mira dhe teknologjitë e përditësuara për përmirësimin e cilësisë e shërbimeve në fushën e mjeteve të rënda.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton procedurat për garantimin e cilësisë në shërbimet teknike sipas standardeve;
- Kontrollon gjendjen teknike të pajisjeve dhe instrumentave përkatës sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Përdor pajisjet dhe instrumentet e diagnostikimit teknik sipas manualeve dhe udhëzimeve të prodhuesit
- Zbaton procedurat teknike gjatë diagnostikimit dhe shërbimeve sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Kryen kontrole përfundimtare të cilësisë pas shërbimeve sipas rregullores së brendshme;
- Dokumenton shërbimet e kryera sipas rregullores së brendshme;
- Tregon përkujdesje për mjedisin dhe menaxhimin e mbetjeve teknike;
- Ndjek procedurat për kryerjen trajnimeve profesionale të vazhdueshme për përditësimin dhe përdorimin e teknologjive të reja.

NjN-23-V-0111-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë zbatimin e parimeve bazë të kodit të punës, legjislacionit bazë lidhur me aktivitetin që kryen;
2. Të klasifikojë llojet e dokumentacioneve;
3. Të klasifikojë llojet e planeve;
4. Të shpjegojë mënyrën e përpilimit të një urdhri pune;
5. Të shpjegojë format dhe mënyrat e ruajtjes së dokumentacioneve;
6. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjeve të materialeve dhe kohës së punës;
7. Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së një oferte;

8. Të shpjegojë llogaritjen e kostos dhe çmimit të një shërbimi;
9. Të klasifikojë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
10. Të shpjegojë rëndësinë e teknikave të marketingut;
11. Të shpjegojë rëndësinë e raportimeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë detyrat administrative dhe tregtare;
2. Të zbatojë teknikat e marketingut.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e lidhur me aktivitetin që kryen;
- Plotëson saktë faturat;
- Harton një plan të thjeshtë biznesit, sipas specifikave përkatëse;
- Harton, ruan dhe arkivon raportet ditore, javore, mujore të punës, sipas rregullores së brendshme;
- Kryen llogaritje të sakta të kostos së mjeteve, materialeve, pajisjeve, pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të kryera në bazë të detyrës së dhënë;
- Llogarit çmimin përfundimtar për shërbimet e ofruara sipas rregullave referuar çmimeve të tregut;
- Zbaton teknikat e duhura të marketingut;
- Merr periodikisht informacionin nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit;
- Identifikon karakteristikat e tregut dhe llojet e konsumatorëve në një sipërmarrje.

NjN-22-V-0130-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit në mënyrë etike dhe profesionale me kolegët, eprorët klientët, supervizorët, institucionet kompetente dhe të tjerë;
2. Të shpjegojë parimet bazë të kodit të etikës në punë;
3. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të punës në grup;
4. Të analizojë metodat e zgjidhjes së problemeve të brendshme dhe të jashtme;
5. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë teknike dhe profesionale me kolegët dhe grupin e punës për realizimin e detyrës;
6. Të shpjegojë rëndësinë e njohurive në gjuhën angleze;
7. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit në komunikimin me të tjerët;
8. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj;
9. Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të hierarkisë.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë teknikat e komunikimit;

2. Të zbatojë kodin e etikës në komunikimin me të tjerët;
3. Të përdorë terminologji profesionale gjatë komunikimit.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton parimet e punës në grup, kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
- Shkëmben udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji profesionale dhe të qartë në komunikim;
- Përdor teknikat e duhura për zgjidhjen e ankesave dhe mosmarrëveshjeve;
- Zbaton rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me kolegët dhe klientët;
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera;
- Vetëvlerëson veten lidhur me mungesën e aftësive referuar proceseve të punës;
- Ndjek trajnimet për ngritje profesionale dhe teknika të reja në punë;
- Përdor TIK në komunikim dhe në proceset e punës, sipas nevojës;
- Merr pjesë në panairë dhe ekspozita për informimin lidhur me teknologjitë e reja.

NjN-12-V-0352-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në mekatronikën e mjeteve të rënda të transportit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
2. Të shpjegojë format e monitorimit të zbatimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve;
3. Të shpjegojë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti dhe mjetet përkatëse;
4. Të shpjegojë format e monitorimit të zbatimit të sinjalistikave në mjedisin e punës
5. Të shpjegojë procedurat e evakuimit në raste emergjente;
6. Të shpjegojë përdorimin e mjeteve të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri dhe procedurat e përkatëse;
7. Të përshkruajë format e mbikëqyrjes së zbatimit të rregulloreve përkatëse gjatë përdorimit të solucionave me përmbajtje kimike të rrezikshme;
8. Të shpjegojë rregullat e sigurimit teknik gjatë përdorimit të gazeve dhe lëngjeve të ndryshme gjatë procesit të punës;
9. Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
10. Të shpjegojë mënyrat e përdorimit racional të energjisë dhe materialeve;
11. Të shpjegojë format e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave të mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
12. Të përshkruajë format e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave për depozitimin e mbetjeve;
13. Të shpjegojë pajisjet e mbrojtjes individuale e kolektive dhe përdorimi i tyre;
14. Të përshkruajë format e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
15. Të shpjegojë protokollat e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme;
16. Të shpjegojë rëndësinë e instruktimit të teknik periodik të stafit dhe dokumentimi i këtij procesi;

17. Të shpjegojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të monitorojë format e zbatimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve;
2. Të kryejë dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti me mjetet përkatëse;
3. Të demonstrojë planin e evakuimit në rast emergjence;
4. Të përdorë mjetet mbrojtëse nga zjarri dhe shpërthimi;
5. Të kontrollojë mënyrën e përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike të rrezikshme;
6. Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik për emetimin e gazrave dhe lëngjeve të tjera;
7. Të zbatojë protokollet përkatëse në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme;
8. Të kryejë instruktimin teknik periodik të stafit dhe dokumentimin e tij.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rregulloret ligjore dhe ato të brendshme që garantojnë shëndetin dhe sigurinë në punë;
- Përdor pajisjet mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë sipas udhëzimeve përkatëse;
- Përdor mjetet dhe pajisjet në përputhje me manualet/udhëzimet e prodhuesit;
- Zbaton masat e mbrojtjes për parandalimin nga goditjet me rrymë gjatë punës me automjete elektrike dhe hibride sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Kryen kontrollin e rregullt të pajisjeve dhe mjeteve mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Zbaton procedurat përkatëse gjatë përdorimit të elementë kimikë të rrezikshëm;’
- Zbaton planin e evakuimit në rast emergjence sipas protokollet përkatëse;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti sipas protokolleve përkatëse;
- Kontrollon mirëmbajtjen e vendit të punës sipas rregullores së brendshme;
- Monitoron ndarjen e mbetjeve të krijuara në procesin e punës sipas llojit dhe protokolleve përkatëse;
- Monitoron klasifikimin dhe magazinimin e materialeve dhe agjentëve kimikë, sipas standardeve përkatës, në mënyrë që të mos rrezikojë mjedisin;
- Kontrollon zbatimin e masa mbrojtëse ndaj ndikimit të çdo gazi të rrezikshëm, toksina, avulli, substanca shumë të ndezshme sipas standardeve;
- Merr masat e duhura në rast derdhesh kimike ose rrjedhjesh të ndonjë reagenti dhe lënde të ndezshme sipas protokolleve përkatëse;
- Përdor energjinë dhe materialet në mënyrë racionale
- Zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm sipas legjislacionit;
- Harton sinjalistikën për mjediset e punës sipas legjislacionit;
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit dhe peshat përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve të punës	6	NjN-12-V-0345-25

	dhe parapërgatitjes për punë		
2	Pranimi, inspektimi dhe diagnostikimi i defekteve në kamionë dhe mjete të rënda	20	NjN-12-V-0346-25
3	Shërbime në sistemet hidraulike dhe pneumatike të kamionëve dhe mjeteve të rënda	10	NjN-12-V-0347-25
4	Shërbime në motor dhe në sistemin e transmetimit të fuqisë në kamionë dhe mjete të rënda	20	NjN-12-V-0348-25
5	Shërbime në sistemet elektrike/elektronike të kamionëve dhe mjeteve të rënda	15	NjN-12-V-0349-25
6	Shërbime në sisteme të komfortit, të sigurisë aktive dhe pasive, të sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit	12	NjN-12-V-0350-25
7	Garantimi i cilësisë së shërbimeve në mjetet e rënda të transportit	3	NjN-12-V-0351-25
8	Sipërmarrje dhe edukim karriere	3	NjN-23-V-0111-24
9	Komunikimi dhe etika profesionale	3	NjN-22-V-0130-24
10	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në mekatronikën e mjeteve të rënda të transportit	8	NjN-12-V-0352-25
Totali		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kritereve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njëjësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftoheshin nëpërmjet këtyre formave:

- ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);

- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **M3-V-25**

M – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

3 – Numri që identifikon profilin/specializimin e kualifikimit përkatës

V – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-12-V-0345-25**

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësisë të të Nxënit

12 – Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

V – Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0345 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësisë të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit